



01 Nr. 479/25 Dt. 05.08.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 37 të Ligjit 06/L-82, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale

1. Adonita Karavidaj, zyrtare ligjore në Komunën e Prizrenit, caktohet si zyrtare për mbrojtjen e të dhënave personale në Komunën e Prizrenit.
2. Detyra dhe përgjegjësit e zyrtarit të caktuar në pikën 1 të këtij Vendimi janë të parapara në Ligjin 06/L-82, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
3. Me këtë Vendim shfuqizohet vendimi nr. 01 nr. 332/25, i datës 02.06.2025.
4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimt të këtij vendimi.
5. Obligohet zyrtarja e lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekures,
 - Ish zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave,
 - Agjencisë për Informim dhe Privatësi,
 - Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
 - Arkivës së Kryetarit.